

VENDIM
Nr. 48, datë 5.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE NR. 37, DATË 13.7.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhë vendimit nr.37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsimi”, thirrja e dytë, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të arsimit, me cikël financimi 2016-2017, me reduktim apo shtesë financimi për vitin 2016, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, dhe saktësim të vlerës së mbetur të financimit për vitin 2017, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla II.

Tabela 1, e vendimit nr.37, datë 13.7.2016, e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, zëvendësohet me tabelën, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e financimit e miratuar për vitin 2016 (Lekë)	Fonde që i reduktohen financimit të vitit 2016 (Lekë)	Fonde që i shtohen financimit të vitit 2016 (Lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017 (Lekë)
QARKU FIER								
1	Bashkia Rrokskovec	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Strum, shkolla fillore Arapaj, shkolla "Naun Doko"	13 749 991	12 676 088	6 874 996		5 801 092	0
QARKU TIRANË								
2	Bashkia Tiranë	Ndërtimi i shkollës "Kosova", Tiranë	281 375 232		100 687 616	60 000 000		240 687 616
3	Bashkia Tiranë	Ndërtimi i sallës së koncerteve Liceu Artistik "Jordan Misja"	118 387 443		59 193 722	50 080 881		109 274 602
TOTALI			413 512 666	12 676 088	166 756 334	110 080 881	5 801 092	349 962 218

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
2. “Fonde që i reduktohen financimit për vitin 2016”, tregon vlerën e fondit që reduktohet nga financimi i miratuar deri tani me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, për objektet që kanë ecuri faktike punimesh, më pak se vlera e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016. Kjo vlerë do të planifikohet për financim në vitin 2017. Vlera e reduktimit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën nr.11191 prot, datë 4.11.2016.
1. “Fonde që i shtohen financimit për vitin 2016”, tregon vlerën e fondit që shtohet mbi financimin e miratuar deri tani me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë vitit 2016, për objektet që kanë ecuri faktike punimesh më shumë se vlera e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016. Kjo vlerë pakëson vlerën e mbetur për financim në vitin 2017. Vlera e që shtohet përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën nr.11191 prot, datë 4.11.2016.
3. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së financimit të realizuar në vitin 2016, dhe vlerës së reduktuar/shtuar me këtë vendim, sipas realizimit në fund të vitit buxhetor 2016.

